

PËRMIRËSIMI I EFICENCËS SË ENERGJISË DHE IMPLEMENTIMI I PANELEVE FOTOVOLTAIKE PËR SHOQËRINË ELBASAN AL-AKUM-329913-CS-QCBS

RAPORT TEKNIK - SHRUK ELBASAN – Mengel Projekt Zbatimi

Ref : ALSP00504E

Dhjetor 2025

Në partneritet me **abkons**
LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards



SEURECA  VEOLIA

PROJEKTUESI



Adres: 30 rue Madeleine Vionnet, Aubervilliers 93300, France
Tel.: (+33) 1 85 57 70 00
contact@seureca.com



LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards
Adres: St. Themistokli Gërmenji, Building No. 6, 1st floor, administrative area No. 2,
1001, Tirana, Albania
Tel.: +355 4 225 8326
info@abkons.com

AUTORITETI KONTRAKTOR



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

National Agency of Water Supply and Sanitation Agjencia
Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve (AKUK) Adres: Rruga Sami

Frashëri, Nr.4, Tiranë, Albania
Tel.: +355 4 225 6091
info@akuk.gov.al

Projekt: National water supply and sanitation sector modernization program

Adres: 34 Ibrahim Rugova St. Tirana, Albania Tel.: +355 4
2280 650/1
infoalbania@worldbank.org

	Emri	Pozicioni	Firma
Përgatitur nga:	Alban DOKO	Inxhinier Hidroteknik & Civil	
	Alban ALIAJ	Inxhinier Elektrik	
	Marsel PYLLA	Inxhinier Mekanik, Ekspert MNZ	
	Erlis MOSHA	Arkitekt	
Kontrolluar nga:	Agustin DELESALLE	Koordinatori i projektit	
Rishikuar nga:	Vincent JALBERT	Drejtimes Projekti	

NR. I KONTRATËS: AL-AKUM 329913-CS-QCBS

PROJEKT

PËRMIRËSIMI I EFICENCËS SË ENERGJISË DHE IMPLEMENTIMI I PANELEVE FOTOVOLTAIKE PËR SHOQËRINË ELBASAN.

NËN PROJEKT

Rindërtimi i platformës së çelikut për mbështetjen e pompave dhe rivendosja e 3 pompa vertikale tip turbinë (VSD) në STP Mengel.

VULA

Licence Nr: 6713/12

FAZA	SHRUK	STP
Projekt Zbatimi	Elbasan	E1
SEKSIONI I PROJEKTIT	KATEGORIA	NR. DOK
GDC	REP	005

NR. I RISH.	PERSHKRIMI	DATA
R00	Dorëzimi i parë	17/12/2025

EMËRTIMI

Raport Teknik

FORMAT	SHKALLA	TIPI	SHKALLES
A4	N/A		N/A

EMRI I DOKUMENTIT: ALSP00504E-E1-T4-005-GDC-REP-A4-Raporti teknik, AL-R00

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje	5
1.1	Informacion mbi misionin	5
1.1.1	Historiku i Projektit	5
1.2	Konteksti i përgjithshëm	5
1.3	Detyrat që i Janë Caktuar Konsulentit	6
1.3.1	Përmbledhje e Shkurtër e Detyrave dhe Dorëzimeve	6
2	Detyra 1 Gjendja Ekzistuese	8
2.4	Sistemi i furnizimit Mengel-Frigorifer	8
2.4.1	Sistemi i furnizimit Mengel	8
2.4.1.1	Stacioni i vjetër Mengel	9
2.4.2	Sistemi i furnizimit Frigoriferi	11
2.4.2.1	Stacioni i vjetër nr.1	11
2.4.2.2	Stacioni i ri nr.1	12
2.4.2.3	Stacioni i ri nr.2	13
2.4.2.4	Stacioni i ri nr.3	13
2.4.2.5	Stacioni i vjetër nr.3	14
2.4.1	Depo Krastë e madhe	16
2.5	Skema primare dhe Planimetria Stp Mengel-Frigorifer	17
2.6	Komente të Përgjithshme Për Raportimin	19
2.7	Investimet nga Donatorë të Tjerë	19
3	Detyra 2 - Matjet dhe Auditi i Eficencës së Energjisë	20
3.1	Fushata e Matjeve	20
3.1.1	Organizimi për Fushatën e Matjeve	20
3.1.2	Plani i Matjeve	20
3.1.1	Matjet në stacionin Mengel-Frigorifer	22
3.1.1	Matjet në stacionin Frigorifer	23
3.1.2	Depo Krastë e Madhe	24
3.2	Auditi i efikasitetit të energjisë në sistemet e furnizimit	25
3.2.1	Humbjet e ujit në dërgim	25
3.2.2	Vlerësim i efikasitetit të pompës	26
3.2.3	Instalimi i matësve të rekomanduar	27
3.2.4	Roli i depove të ujit	28
3.2.5	Rekomandimet mbi instalimet e furnizuesve elektrik	30
3.2.6	Analiza e potencialit për energji të rinovueshme	30
3.3	Projektet e Parafizibilitetit të Propozuara	32
3.4	Komentet dhe Analiza për Rajonin Elbasan	35
4	Detyra 3 – Projekt Ide	36
4.5	Zëvendësimi I Pompave Tek Stacioni i Mengelit	37

4.6	Komentet Për Detyrën 3	39
5	Detyra 4 – Projekt Zbatimi	40
5.1	Pershkrimi i Pergjithshem i Rehabilitimit Të Stp Mengel	40

1 HYRJE


1.1 INFORMACION MBI MISIONIN

1.1.1 HISTORIKU I PROJEKTIT

Bazuar Termat e referencës (Detyra e projektimit) si dhe në “Strategjia kombëtare e sektorit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin, grumbullimin e trajtimin të ujërave të ndotur urban, 2023 – 2030” Kryesisht sipas strategjise, në pikën 3.4 Qëllimet e Politikës dhe Rezultatet / Masat Prioritare, Tabela 2, Politika 4, “Implementimi i një qasje të re në investimet në sektor drejt reduktimit të konsumit të energjisë, nëpërmjet investimeve për furnizimin me energji nga fotovoltaiket, vendosjes së pompave sipas kriterëve të BE dhe instalimi i programit SCADA që rrit efektshmërinë e tyre”.

Si pjesë e “Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve” në Shqipëri, ekipi i Bankës Botërore, AKUK dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë planifikojnë të zbatojnë projekte për efikasitetin të energjisë dhe energjinë e rinovueshme në ndërmarrjet e ujësjellësit.

Misioni i Konsulentit bazohet në Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri. Ai synon të përmirësojë performancën operative dhe financiare të shoqërive UK dhe të rrisë aksesin në shërbimet e furnizimit me ujë të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Republikën e Shqipërisë.



Korniza e AT e konsulentit

Figura 1 Korniza e TA e konsulentit

1.2 KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM

Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve të Shqipërisë (Banka Botërore, AKUK, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), synon të rrisë efikasitetin të energjisë dhe të promovojë projektet e energjisë së rinovueshme brenda shoqërive të ujësjellësve.

Programi global synon një reduktim prej 25% të konsumit të energjisë gjatë një periudhe 20-vjeçare, me kursime të pritshme prej 400 GWh.

Strategjia energjetike e Shqipërisë thekson zgjerimin dhe rritjen e burimeve të rinovueshme të energjisë, veçanërisht diellore, me plane për të rritur energjitë jo-hidrike të rinovueshme në 640 MW deri në vitin 2030.

Detyrimet ligjore sipas ligjit shqiptar kërkojnë që konsumatorët e mëdhenj të energjisë, duke përfshirë shumicën e ndërmarrjeve të ujësjellësit, t'i nënshtrohen auditimeve të energjisë. Pajtueshmëria me direktivat e BE-së për efikasitetin e energjisë është gjithashtu thelbësore, duke bërë të nevojshme adoptimin e teknologjive dhe shërbimeve të reja për të përmbushur qëllimet e qëndrueshme.

1.3 DETYRAT QË I JANË CAKTUAR KONSULENTIT

Kontrata e Shërbimit të Konsulentit u nënshkrua më 23 Maj 2024, në Tiranë, nga të dyja palët, Z. Klevis Jahaj, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK-ut, që përfaqëson klientin AKUK, dhe Z. Vincent Jalbert, drejtues i ekipit, që përfaqëson konsulentin, Konsorciumin Seureca & Abkons Shpk. Kjo datë shënon gjithashtu fillimin e projektit.

Projekti i Auditimit të Efikasitetit të Energjisë për Rajonin e Elbasanit ka kaluar në disa faza të ashtuquajtura Detyra sipas Termave të Referencës.

Aktiviteti	Dorëzimi
DETYRA 1	D1: Raporti fillestar për gjetjet, mbledhjen e të dhënave dhe fazën e planifikimit
	D2: Raport mbi Raportin Bazë dhe të Detyrës së Projektimit
DETYRA 2	D3: Draft Raporti i matieve
	D4: Raporti i studimit paraprak të fizibilitetit
DETYRA 3	D5: Raporti i Llogaritjeve
	D6: Vizatimet Konceptuale
	D7: Draft Raporti i Studimit të Objektivit të VNM-së dhe Termat e Referencës
	D8: Draft Raporti Final
DETYRA 4	D9: Dokumente Tenderimi
	D10: Raporti Final

Figura 2 Përmbledhje e detyrave të projektit

1.3.1 PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E DETYRAVE DHE DORËZIMEVE

Detyra 1. Gjendja Ekzistuese

Në këtë fazë është bërë takim me Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Elbasan. Në bashkëpunim me ta janë mbledhur të dhëna rreth sistemeve të furnizimit me ujë me ngritje mekanike (qëllimi i projektit) dhe me vetërrjedhje. Mbas mbledhjes së të dhënave (bazuar në një tabelë me kërkesa të dorëzuar SHRUK) është bërë analizimi i tyre për të evidentuar se kush nga sistemet prodhon më shumë ujë dhe harxhon më shumë energji në mënyrë që në fazat e mëtejshme ata të studiohen më në detaje.

Për detyrën 1 janë dorëzuar dy raporte në të cilat përmbahet informacion i detajuar për të dhënat e mbledhura dhe gjendjen ekzistuese për informacion me të zgjeruar duhet të referoheni raportit:

- D1 – Raporti Fillestar- ALSP00504E.AL
- D2 - Raporti i gjendjes ekzistuese- Elbasan - ALSP00504E

Detyra 2. Matjet dhe Raporti i Parafizibilitetit për Auditimin e Efikasitetit të Energjisë

Mbasi është bërë mbledhja e informacioneve nga SHRUK Elbasan e cila u shërben bashkive: Elbasan, Peqin, Gramsh, Belsh, Cërrik dhe Librazhd, janë bërë dhe vizita në terren për të evidentuar dhe plotësuar informacionin e gjendjes ekzistuese. Nga këta janë përzgjedhur disa nga sistemet më kryesore, sistemi i Mengelit dhe Frigoriferit, sistemi i Krastës së Vogël, sistemi i Cërrikut, sistemi i Peqinit ku të gjithë këta zënë në total rreth 75% të konsumit të energjisë që harxhon Rajoni i Elbasanit për sistemet e furnizimit me ujë. Për këto sisteme është realizuar një fushatë matjeje e parametrave të pompave (prurje, presion, fuqi) dhe për matjen e sistemit të dërgimit (matje për 3 ditë e prurjes në dalje të stacionit dhe matje e prurjes në hyrje të depove). Pas analizimit të të dhënave të matura janë përcaktuar rendimentet e pompave, problematikat ose humbjet teknike në rrjetin kryesor (nga stacioni tek depot), dhe më pas janë dhënë zgjidhje në mënyrë që të kemi një rritje të efikasitetit të energjisë. Zgjidhja konsiston në përmirësimin e pajisjeve elektromekanike dhe prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme (penele diellore).

Për detyrën 2 janë dorëzuar dy raporte në të cilat përmbahet informacion i detajuar për të dhënat e matura dhe Auditin e efikasitetit të energjisë në sistemet e furnizimit Mengel/Frigorifer, Krastë e Vogël, Cërrik dhe Peqin për informacion me të zgjeruar duhet të referoheni raportit:

- D3 – Aneksi me Matjet - SHRUK Elbasan
- D4 - Raporti i Parafizibilitetit- SHRUK Elbasan

Detyra 3. Projekt Ideja

Mbas përfundimit të Detyrës 2, faze në të cilën zgjidhen dhe llojet e ndërhyrjeve që do të kryhen në sistemet për të reduktuar harxhimin e energjisë në një përqindje rreth 16-20%. Në këtë fazë janë paraqitur skicë idetë dhe parametrat e pompave ose dhe ndërhyrjeve të tjera.

Për detyrën 3 është dorëzuar dosja me: Raportin e Projekt Idesë, Vizatimeve Teknike Draft, Grafikun e Punimeve, Specifikimet Teknike Draft, Volumet dhe Kosto e Punimeve paraprake.

Projekt Ideja është paraqitur në keshillin teknik në AKUK në datën 21 Nëntor 2025 dhe mbi baze të vendimeve të këtij keshilli teknik është vazhduar me Projekt Zbatimin.

Detyra 4. Projekt Zbatimi

Mbas përfundimit të Detyrës 3, janë reflektuar komentet dhe vërejtjet e bëra nga keshilli teknik dhe më pas janë përgatitur dokumentacionet përfundimtare të cilat duhen për aplikimin për oponente dhe më pas për tenderimin e projekt zbatimit.

2 DETYRA 1 GJENDJA EKZISTUESE

Mbas mbledhjes së informacionit nga SHRUK Elbasan(sistemet, pajisjet, faturat e energjisë elektrike, matjet e sasisë së ujit të prodhuar) dhe analizës së tyre në fazën fillestare, u përcaktuan që 5 ishin sistemet kryesore (Mengel/Frigorifer, Krastë e Vogël, Cërrik, Peqin dhe Belsh) për të cilat dhe do të vazhdohej investigimi dhe analiza e detajuar e Auditimit të Eficencës së energjisë.

Këto sisteme të cilët zënë në total rreth 61% të konsumit të energjisë që harxhon Rajoni i Elbasanit për sistemet e furnizimit me ujë (Shih Tabelën Më poshtë).

Tabela 1 Sasia e Ujit të Prodhuar dhe Energjia e Konsumuar nga SFU në SHRUK Elbasan

Sistemi	UJI I PRODHUAR (m ³)		KONSUMI I ENERGJISË - 2023 (kWh)	
	Total (2023)	% of TOTAL	Totali (2023)	% nga TOTALI
MENGELI TOTAL	3,067,982	20%	2,029,200	14%
FRIGORIFERI TOTAL	7,018,165	45%	2,506,000	18%
KRASTE E VOGEL TOTAL	3,088,523	20%	1,250,400	9%
PISHAT TOTAL	726,466	5%	1,045,000	7%
LUMI TOTAL	1,726,434	11%	1,791,431	13%
TE TJERA			5,522,000	39%
TOTALI	15,695,926	100%	14,144,031	100%

Në datën 26 Qershor 2024 u zhvillua një vizitë në stacionet kryesore të pompimit të SHRUK Elbasan, nën drejtimin e Koordinatorit të Elbasanit Z. Julian Doci. Në kuadër të kësaj vizite në terren janë mbledhur edhe disa të dhëna të reja që janë vendndodhja e sistemeve Mengel, Frigorifer, Krastë e Vogël, Peqin dhe Cërrik duke përfshirë këtu dhe (pompat, puset, depot e ujit etj).

2.4 SISTEMI I FURNIZIMIT MENGEL-FRIGORIFER

Sistemi perbehet nga dy Komplekse Stacionesh Pompash, ne Mengel dhe Ne Frigorifer. Uji nga keto stacione dergohet vec e vec nga secili sistem dhe bashkohet ne afersi te daljes tek Stacioni i Frigoriferit, me pas shkon me nje tubacion te perbashket DN 600 drejt Depove ne Kraste te Madhe.

2.4.1 SISTEMI I FURNIZIMIT MENGEL

Sistemi i Mengelit përbehet nga 2 stacione pompimi (i riu dhe i vjetri) dhe dërgojnë ujë në depot Krastë e Madhe. Të dy këto stacione furnizohen nga i njëjti pus. Stacioni i ri i pompimit përbëhet nga 3 pompa zhytëse që aktualisht janë jashtë pune dhe kanë këto karakteristika (Q=90 l/s, H=87 m dhe P=126 kW). Pompat janë të reja të vitit 2014.

Tabela 2 Tabela e pompave zhytëse Mengel

Nr. i pompës	1	2	3
Prurja (l/s)	90	90	90
Presioni (m)	87	87	87
Fuqia (kW)	126	126	126
Viti	2014	2014	2014



Figura 3: Pusi që ndodhet në stacionin e pompimit Mengel.



Figura 4: Pompat zhytëse në stacionin e ri Mengel.

2.4.1.1 Stacioni i vjetër Mengel

Stacioni i vjetër i pompimit në Mengel përbëhet nga 4 pompa centrifugale horizontale me karakteristika ($Q=115$ l/s, $H=103$ m dhe $P=220$ kW). Aktualisht punojnë me dy pompa pasi dy janë jashtë shërbimi. Pompat nga stacioni i vjetër dalin me tub çeliku DN400 dhe kanë matës. Stacioni i vjetër bashkohet me stacionin e ri në një pusetë dhe dalin me tub çeliku DN400 drejt stacionit të Frigoriferit.



Figura 5: Pompat në stacionin e vjetër Mengel.

Tabela 3 Karakteristikat e pompave në stacionin e vjetër Mengel

Pompa nr.	1	2	3	4
Prurja (l/s)	115	115	115	115
Presioni (m)	103	103	103	103
Fuqia (kW)	220	220	220	220
Viti	1975	1975	-	-



Figura 6: Matja e ujit në dalje të stacionit Mengel

Disa shënime për këtë stacion:

- Matësi i ujit është përdorur për linjat dalëse (është total)
- Pompat ishin në gjendje të keqe
- Sistemi i kontrollit është manual

Në zonën e stacionit të pompimit dhe gjithashtu në puse ka rreth 4.9 ha për t'u konsideruar për zhvillimin e impianteve PV

2.4.2 SISTEMI I FURNIZIMIT FRIGORIFERI

Sistemi i furnizimit të Frigoriferit përbëhet nga 5 stacione pompimi. Nga këta 2 janë stacione të vjetra dhe 3 janë stacione të rinj. Të gjithë këto stacione çojnë ujë te depot Krastë e Madhe.

2.4.2.1 Stacioni i vjetër nr.1

Stacioni i vjetër nr.1 është stacion i ndërtuar rreth viteve 1963 dhe përbëhet nga 2 pompa centrifugale horizontale me karakteristika ($Q=115$ l/s, $H= 103$ m dhe $P=220$ kW) dhe vetëm njëra punon, ndërsa tjetra është jashtë funksioni. Secila nga këto pompa thith ujë nga një pus i veçantë. Stacioni i vjetër nr. 1 është ngjitur me stacionin e ri nr.1. Aktualisht ky stacion është jashtë përdorimi, por që mund të përdoret në rast avarie të stacionit të ri.



Figura 7 : Stacioni i vjetër nr.1 Frigorifer.



Figura 8: Stacioni i vjetër nr.1

Tabela 4 Karakteristikat e pompave në stacionin e vjetër nr.1 Frigorifer.

Nr. i pompës	1	2
Prurja (l/s)	115	115
Presioni (m)	103	103
Fuqia (kW)	220	220
Viti	1963	1971

2.4.2.2 Stacioni i ri nr.1

Stacioni i ri i pompimit nr.1 Frigoriferit ndodhet ngjitur me stacionin e vjetër nr.1 dhe përbëhet nga 2 pompa vertikale tip turbine me karakteristika ($Q=125$ l/s, $H=77$ m, $P=132$ kW). Stacioni është i ndërtuar rreth viteve 2005 dhe është i ndërtuar mbi pusin ekzistues.

Ne stacionin e ri pompat janë të pajisura me matës elektronik të prurjes.



Figura 9 Stacioni i ri nr.1 në të majtë (ngjitur stacioni i vjetër).

Tabela 5: Karakteristikat e pompave në stacionin e ri nr.1 Frigorifer.

Nr. i pompës	1	2
Prurja (l/s)	125	125
Presioni (m)	77	77
Fuqia (kW)	132	132
Viti	2005/2006	2005/2006



Figura 10: Pompat e stacionit nr.1 Frigorifer

2.4.2.3 Stacioni i ri nr.2

Stacioni i ri nr.2 i Frigoriferit përbëhet nga dy pompa centrifugale vertikale tip turbinë me karakteristika ($Q=125$ l/s, $H=77$ m, $P=132$ kW). Stacioni është i ndërtuar rreth viteve 2005 dhe është i ndërtuar mbi një pus të ri. Është i ngjashëm me stacionin nr.1 të ri për arsye të mirëmbajtjes dhe përdorimit të pjesëve për njëra-tjetrën. Edhe këtu operohet vetëm me 1 pompë ndërsa tjetra rezervë.



Figura 11: Godina e stacionit i ri nr.2



Figura 12: Stacioni nr.2 i ri

Pompat te stacioni nr.2 i ri janë të vendosura mbi një platformë metalike mbi pus.

Tabela 6: Karakteristikat e pompave në stacionin e ri nr.2 Frigorifer.

Nr. i pompës	1	2
Prurja (l/s)	125	125
Presioni (m)	77	77
Fuqia (kW)	132	132
Viti	2004	2004

2.4.2.4 Stacioni i ri nr.3

Stacioni i ri nr.3 ndodhet ngjitur me stacionin e vjetër dhe përbëhet nga 2 pompa centrifugale vertikale tip turbine të ngjashme me stacionin 1 dhe 2 të ri. Karakteristikat e pompave janë ($Q=125$ l/s, $H=77$ m, $P=132$ kW).



Figura 13: Godina e stacionit të ri nr.3, ngjitur stacioni nr.3 i vjetër (majtas)



Figura 14: Stacioni i ri nr.3

Tabela 7: Karakteristikat e pompave në stacionin e ri nr.2 Frigorifer.

Nr. i pompës	1	2
Prurja (l/s)	125	125
Presioni (m)	77	77
Fuqia (kW)	132	132
Viti	2004	2004

2.4.2.5 Stacioni i vjetër nr.3

Stacioni i vjetër nr 3 përbëhet nga 2 pompa centrifugale horizontale (dikur 4, por që 2 mungojnë) me karakteristika ($Q=115$ l/s, $H=103$ m, dhe $P=220$ kW). Furnizohen nga i njëjti pus ku është ndërtuar stacioni i ri nr.3. Aktualisht ky stacion është jashtë përdorimi.



Figura 15: Stacioni i vjetër nr.3.

Tabela 8: Karakteristikat e pompave në stacionin e vjetër nr.3 Frigorifer.

Nr. i pompës	1	2
Prurja (l/s)	115	115
Presioni (m)	103	103
Fuqia (kW)	220	220
Viti	1963	1963

Të gjitha stacionet e Frigoriferit bashkohen në një tub në një pusëtë bashkimi dhe dërgojnë ujë në depot Krastë e Madhe. Secili nga tubat ka matës të veçantë dhe dalin me tub DN600 I cili disa metra më tutje bashkohet me tubin DN400 që vjen nga Mengeli.



ira 16: Tubi që vjen nga stacioni nr.1



ira 17: Tubi që vjen nga stacioni nr.2



ira 18: Tubi që vjen nga stacioni nr.3

Disa shënime për këto stacione:

- Matësi i ujit është përdorur për linjat dalëse (është total)
- Pompat ishin në gjendje të mirë
- Sistemi i kontrollit është manual

Në zonën e stacionit të pompimit dhe gjithashtu në pusë ka rreth 4 ha për t'u konsideruar për zhvillimin e impianteve PV

2.4.1 DEPO KRASTË E MADHE

Në total janë 4 depo me volume përkatësisht 3 depo me nga 2000 m³ dhe 1 depo 500 m³ kjo e fundit mbushet me vetërrjedhje nga depo Krastë e madhe nr.2. Janë në kuotën 186.0 mmnd dhe furnizojnë 75% të qytetit të Elbasanit me ujë.



Figura 19: Depot Krastë e Madhe

2.5 SKEMA PRIMARE DHE PLANIMETRIA STP MENGEL-FRIGORIFER




Figura 20 Planimetria e Sistemit Mengel-Frigorifer




Figura 21: Skema e Sistemit Mengel-Frigorifer

2.6 KOMENTE TË PËRGJITHSHME PËR RAPORTIMIN

Konsulenti vëzhgoi dy lloje raportimi për bilancet e ujit dhe energjisë:

- Raportimi në nivel bashkie
- Raportimi në nivel sistemi

Raportimi në AKUK nga SHRUK Elbasan kryesisht shfaqet në formën e raportimit në nivel bashkiak. Kjo metodë grumbullon të dhëna në të gjitha sistemet brenda një bashkie, duke ofruar një pasqyrë të gjerë, por pa detaje specifike. Në të kundërt, kontabiliteti në nivel sistemi zërthen konsumin e energjisë nga sistemet individuale, të tilla si stacionet e pompimit ose impiantet e trajtimit. Kjo qasje ofron një kuptim të detajuar se ku përdoret energjia në mënyrë efikase ose ku po harxhohet. Raportimi në nivel sistemi është veçanërisht i dobishëm për përpjekjet për efikasitetin e energjisë. Ai lejon identifikimin e saktë të operacioneve me energji intensive dhe lehtëson zbatimin e ndërhyrjeve të synuara për të reduktuar konsumin. Me të dhëna të detajuara të nivelit të sistemit, deficienat mund të identifikohen, nevojat për mirëmbajtje mund të vlerësohen më saktë dhe masat e kursimit të energjisë mund të zbatohen në mënyrë strategjike aty ku do të kenë ndikimin më të madh.

Të dhënat e detajuara të konsumit të energjisë janë të disponueshme në baza mujore për të gjitha sistemet e SHRUK Elbasan, dhe ato bazohen vetëm në faturat e OSHEE. Madhësia e konsiderueshme e këtyre sistemeve dhe konsumi i tyre i energjisë justifikon zbatimin e matjes së detajuar të energjisë, e cila do të siguronte disa përfitime kryesore:

- Të bëhet një verifikim i dyfishtë i saktësisë së faturave të OSHEE.
- Ndarja e konsumit të energjisë për prodhimin e ujit nga ai i transmetimit.
- Monitorimi i konsumit të energjisë së objekteve ujore për të identifikuar çdo devijim nga vlerat e pritura bazuar në KPI-të e rekomanduara.
- Të monitorohet konsumi i energjisë të objekteve për të cilat konsumi i energjisë aktualisht nuk dihet.

Fatkeqësisht, mungesa aktuale e raportimit sistematik të konsumit të energjisë pengon aftësinë për të monitoruar me saktësi dhe optimizuar përdorimin e energjisë. Ky boshllëk raportimi jo vetëm që errëson kostot e vërteta të energjisë, por gjithashtu kufizon mundësitë për përmirësime të synuara të efikasitetit, duke e bërë të vështirë zbatimin e strategjive efektive të menaxhimit të energjisë.

2.7 INVESTIMET NGA DONATORË TË TJERË

Në sistemin e Furnizimit të Uje të Qyteti të Elbasanit në rrjetin e shpërndarjes është duke u ndërtuar dhe rehabilituar rrjeti me financim të KfW.

3 DETYRA 2 - MATJET DHE AUDITI I EFICENCËS SË ENERGJISË

Objektivat kryesore që u trajtuan në këtë fazë janë:

1. Matja dhe nxjerrja e rezultateve në sistemet e ujit të Mengel, Frigorifer, Krastë e Vogël, Cërrik dhe Peqin në SHRUK Elbasan.
2. Vlerësimi i performancës së energjisë së pompave bazuar në këto matje.
3. Arritja e disa konkluzioneve për optimizimin e përdorimit të ujit dhe energjisë, përfshirë rinovimet, zëvendësimet dhe përmirësimet e infrastrukturës
4. Eksplorimi i mundësive alternative të prodhimit të energjisë, përfshirë energjinë nga panelet diellore, riciklimin e energjisë nga ujërat e zeza dhe potencialin hidrik.

3.1 FUSHATA E MATJEVE

3.1.1 ORGANIZIMI PËR FUSHATËN E MATJEVE

Fushata e matjeve u bazua në elementët kyç të mëposhtëm. Për SHRUK Elbasan, matjet u realizuan në periudha të ndryshme:

- Matja e performancës së pompave u bë në datat 20, 21, 22 Gusht 2024 (Mengel, Frigorifer, Krastë e Vogël) dhe në 24 Shtator2024 (Cërrik, Peqin)
- Matja e Linjës së dërgimit:
 - 1 16/09/2024 deri më 20/09/2024 për Mengel/Frigorifer – Krastë e Madhe
 - 2 20/09/2024 deri më 21/09/2024 për Krastë e Vogël
 - 3 24/09/2024 deri më 26/09/2024 për Cërrik –Beu/Antena
 - 4 24/09/2024 deri më 27/09/2024 për Peqin - Spitali

Qëllimi i fushatës së matjeve është që të vlerësohet në mënyrë të detajuar:

- Eficenca e energjisë në prodhimin e ujit dhe dërgimin e ujit në lidhje me performancën e pompave;
- Vlerësimi i linjës së dërgimit nga stacioni i pompimit deri në depo, si dhe vlerësimi i kapaciteteve të magazinimit të ujit në depo.

3.1.2 PLANI I MATJEVE

Fushata e matjeve u realizua nga një ekip ekspertësh për efikasitetin e energjisë. Në matje u përfshinë të gjitha objektet funksionale duke përjashtuar ato që ishin të çaktivizuara, nën mirëmbajtje si dhe ato me kufizime operative gjatë momentit të fushatës. Metodologjia ndoqi karakteristikat e përmendura më poshtë.




Figura 22 Metodologjia auditimit të ujit dhe energjisë.

Matja u bë në dy kategori, ku e para ishte matja pikësore kur përfshin matjen e pompës në moment për prurjen, presionin si dhe konsumin aktual të energjisë. Kategoria e dytë e matjeve ishte ajo e matjeve të vazhdueshme që konsistonte në matjen e linjës dhe përfshijnë matje 3 ditore.

Pajisjet që u përdoren për matje jepen në tabelë e mëposhtme. Çdo pajisje ishte paraprakisht e kalibruar.

Tabela 9 Instrumentat e përdorur në fushatën e matjeve

Emri i pajisjes	Funksioni	Ilustrimi
Matës niveli i ujit me sinjalizues me drite	Mat nivelin e një sipërfaqe të lirë uji. Niveli mund të lexohet në shirit kur ndriçohet, që do të thotë se extremiteti ka prekur në ujë.	
Matës niveli i ujit dhe mbledhës të dhënash	Mat dhe regjistron presionin përmes një manometri të integruar të zhytur në fund.	
Matës presioni dhe mbledhës të dhënash	Mat dhe regjistron presionin e ujit në tub. Lidhet me një rubinet/saraçineskë.	
Prurje matës me valë/tinguj	Mat dhe regjistrojnë prurjen e ujit në një tub. Është një pajisje jo-dëmtuese që përdor sensor të vendosur në pjesën e jashtme të tubit.	
Matës Fuqie dhe energjie (tipi - PEL)	Mat dhe regjistron tensionin, intensitetin e rrymës, faktorin e fuqisë, fuqinë reaktive dhe aktive të motorit. Zakonisht, lidhet me panelin elektrik.	

Llogaritja e performancës së pompave

Për të përcaktuar vlerën e performancës së pompës, ekipi kryen matje elektrike ashtu edhe hidraulike.

Performanca e pompës (η) vlerësohet duke krahasuar fuqinë hidraulike të bërë nga pompa me konsumimin elektrik të pompës. Rendimenti i pompës dhe rendimenti i përgjithshëm janë ndarë:

- Rendimenti i përgjithshëm përfshin motorin në llogaritjen e tij, ai përfaqëson rendimentin e të gjithë sistemit (Pompë + Motor);
- Rendimenti i pompës mat vetëm performancën e vetë pompës, duke nxjerrë punën e motorit

Si pjesë e vlerësimit të rendimentit të energjisë, duhen kryer matjet e mëposhtme për të mundësuar llogaritjen e rendimentit të pompës:

Matjet Hidraulike:

- Matja e prurjes në dalje të pompës
- Matja e lartësisë së ujit në dalje të pompës
- Matja e lartësisë së ujit në thithje:

Matjet Elektrike:

- Matja e tensionit në secilën fazë në panelin e kontrollit të pompës dhe furnizimin elektrik
- Matja e intensitetit të rrymës në secilën fazë në panelin e kontrollit të pompës dhe furnizimin elektrik
- Matja e faktorëve të fuqisë në secilën fazë në panelin e kontrollit të pompës dhe furnizimin elektrik.

Pika operative e pompës i referohet prurjes që ajo mund të dorëzojë për një lartësi të caktuar. Kjo lartësi është projektuar për të përputhur **humbjet totale të lartësisë** (të dyja lineare dhe jo-lineare) brenda rrjetit ku është instaluar pompa, si dhe çdo kërkesë për lartësi statike. **Kurba karakteristike e pompës** tregon aftësitë operuese të saj, me çdo pikë operative që përputhet me një rendiment specifik të pompës.

3.1.1 MATJET NË STACIONIN MENGEL-FRIGORIFER

Për pompat e stacionit të Mengelit matjet pikësore u bënë vetëm në stacionin e vjetër. Matjet u bënë për disa raste. Pompa P1 me hapje të valvulave 100%, 50% dhe 20% si dhe pompa P2 me hapje 100%, 50% dhe 20%, si dhe të dyja pompat njëkohësisht në punë me hapje 100% dhe 50%. Matja e vazhdueshme konsistoi në matjen e linjës së Mengelit dhe të presionit në dalje të linjës.






Figura 23: Matja e prurjes në dalje të stacionit të Mengelit



Figura 24: Matja e presionit në dalje të stacionit Mengel

Matjet e Detajuara janë dhënë ne Aneksin e Matjeve D3. Përveç formatit pdf matjet janë dorëzuar dhe ne format Excel-i.

3.1.1 MATJET NË STACIONIN FRIGORIFER

Stacioni i Mengelit dhe i Frigoriferit çojnë së bashku ujë në depot Krastë e Madhe dhe si pasojë matja duhet të bëhet njëkohësisht. Matjet në stacionin e Frigoriferit u bë në stacionet e reja pasi të vjetrat nuk përdoren më. Dhe këtu matjet u bënë me valvula të hapura 100%, 50% dhe 20% për të gjitha pompat e stacioneve më saktë pompa P2 stacioni nr.1, pompa P2 stacioni nr.2 dhe të dyja pompa ne stacionin nr.3. Matjet ishin pikësore dhe të vazhdueshme.



Figura 25: Matja në pompat e stacionit nr.1 i Ri



Figura 26: Matja në pompat e stacionit nr.2 i Ri



Figura 27: Matja në pompat e stacionit nr.3 i Ri

3.1.2 DEPO KRASTË E MADHE

Matja e prurjes dhe matja e nivelit të ujit u bë në depot Krastë e Madhe për të parë humbjet në linjën e dërgimit si dhe luhatjen e depove gjatë ciklit ditor. Krasta e Madhe përbëhet nga 4 depo ku 3 janë të ngjashme 2000m³ dhe 1 e vogël me volum 500m³



Figura 28: Matja e prurjes në tubin kryesor që sjell ujë në depot




Figura 29: Matja e nivelit të ujit në depon nr.1 Krastë e Madhe



Figura 30: Matja e nivelit të ujit në depon nr.2 Krastë e Madhe




Figura 31: Matja e nivelit të ujit në depon nr.3 Krastë e Madhe

Vendndodhja e matësve të linjës për FU_E1




Figura 32: Skema hidraulike dhe vendndodhja e pikave të matjes së prurjes dhe presionit për skemën e Mengel/Frigorifer

3.2 AUDITI I EFICENCËS SË ENERGJISË NË SISTEMET E FURNIZIMIT

Qëllimi i këtyre matjeve në rrjet ishte të kuptohej më mirë kushtet operative të rrjetit të dërgimit të ujit nga Stacionit të Pompimit (StP) në depo. Ky vlerësim i prurjes së ujit të dorëzuar nga një Stacion pompimi në një depo tjetër çon në disa përfundime:

1. Kuptimi i plotë i funksionimit të sistemit: ku valvulat janë pjesërisht të hapura ose kanë rrjedhje.
2. Vlerësimi i nivelit të volumit të ujit të pamatur në linjat kryesore ai një qasje e parëpër të identifikuar linjat me rrjedhje të mëdha ose valvulat pjesërisht të hapura që mund të mos jenë identifikuar më parë.

3.2.1 HUMBJET E UJIT NË DËRGIM

FU E1 Mengel/Frigoriferi




Figura 33 Humbjet e ujit nga stacioni i Mengel/Frigorifer drejt depove Kraste e Madhe

Shënim: Shifrat përfaqësojnë vlera mesatare të llogaritura gjatë periudhës së matjes. Është interesante që, në disa raste, humbjet e llogaritura të ujit japin rezultate negative. Konsulenti hipotezon se stacioni i ri i pompave në Mengel, i cili raportohet të ishte jooperacional sipas informacionit të operatorit, mund të ketë qenë në fakt në funksionim dhe të ketë prodhuar ujë që më pas është drejtuar në rezervuarët e Krastë e Madhe. Një hetim është aktualisht në proces për të përcaktuar rrethanat e sakta dhe për të sqaruar situatë.

Matjet mundësuan Konsulentit të identifikojë përqindjen e humbjeve të ujit në linjat e dërgimit/transportit të ujit, e cila është në një nivel relativisht të ulët:

- 5.5% për Mengel/Frigoriferi → Depot e Krastës së Madhe

Komente:

Duke marrë parasysh nivelin e ulët të humbjeve, nuk rekomandohet ndonjë veprim korrigjues i menjëhershëm. Megjithatë, rekomandohet fuqishëm monitorimi i rregullt, pasi një rritje e kësaj humbjeje mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm në balancën e ujit si dhe në efikasitetin e përgjithshëm energjetik të sistemit të ujit

3.2.2 VLERËSIM I EFIÇIENCËS SË POMPËS

Një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse është hartuar nga matjet e kryera gjatë hetimit të secilës pompë. Këto informacione të vlefshme shërbejnë si baza për studimin e efikasitetit të energjisë të Konsulentit. Për secilin stacion pompimi, gjendja e pompave përkatëse është detajuar në fletë të dhënash të matjeve të dedikuara që u përmendën më parë. Gjetjet e kësaj analize të efikasitetit të energjisë paraqiten në seksionet e mëposhtme, duke ofruar pasqyra mbi performancën dhe mundësitë e optimizimit për secilën pompë të hetuar.

Qasja përfshin krahasimin e daljes së matur të pompës me vlerat e pritshme të standardeve për kategorinë specifike të pompimit. Diferenca midis këtyre dy shifrave tregon mundësinë për reduktimin e fuqisë. Kjo mundësi më pas kthehet në kursime energjie duke përfshirë orët mesatare ditore të operimit të pompës.

Tabela më poshtë sintetizon rezultatet për të gjitha pompët që u nënshtuan fushatës së matjeve dhe krahason prodhimin e matur me prodhimin optimal dhe prodhimin e garantuar.

- **Prodhimi optimal** është rendimenti maksimal që pompa mund të arrijë në kushte ideale. Ai arrihet në pikën nominale të operimit të pompës. Përfaqëson performancën më të mirë të mundshme të pompës.

Prodhimi i garantuar është rendimenti minimal që prodhuesi angazhohet të sigurojë. Ai është zakonisht më i ulët se rendimenti optimal për të marrë parasysh tolerancat e prodhimit dhe kushtet reale të operimit. Ky është një vlerë kontraktuale që prodhuesi angazhohet të sigurojë.

Për të ruajtur një qëndrim të kujdesshëm, ne vlerësojmë kursimet e mundshme të energjisë në krahasim me prodhimin e garantuar. Për qëllime informacioni, tabela gjithashtu paraqet figurat e prodhimit optimal.

Me poshte jepen tableat me te dhenat e matura dhe rendimentet e analizuara per stacionet e pompave në Mengel-Frigorifer.

Tabela 10 Stacioni i pompimit Mengel

#	SHRUK	Bashkia	Stacioni i pompimit	Njësia	Nr. i pompës	Statusi nga matjet	Të matura					Optimali	
							Prurja (m ³ /h)	Presioni (m)	Fuqia aktive (kW)	Faktor i fuqisë (0 < cosφ < 1)	Rendimenti η (performanca) %	Efienca e energjisë (wh/m ³ /mku)	Rendimenti i synuar η (performanca) %
14	Elbasan	Elbasan	Mengel	Stp i Vjetër	P1	Përfunduar	218	82	151.2	0.89	32.4%	8.414	75.68%
15	Elbasan	Elbasan	Mengel	Stp i Vjetër	P2	Përfunduar	247	83	162.0	0.88	34.3%	7.936	75.79%
16	Elbasan	Elbasan	Mengel	Stp i Vjetër	P3	Çmontuar							
17	Elbasan	Elbasan	Mengel	Stp i Vjetër	P4	Çmontuar							
18	Elbasan	Elbasan	Mengel	Stp i ri	P1	Jashtë shërbimi							
19	Elbasan	Elbasan	Mengel	Stp i ri	P2	Jashtë shërbimi							
20	Elbasan	Elbasan	Mengel	Stp i ri	P3	Jashtë shërbimi							

Tabela 11 Stacioni i pompimit Frigoriferi

#	SHRUK	Bashkia	Stacioni i pompimit	Njësia	Nr. i pompës	Statusi nga matjet	Të matura					Optimali	
							Prurja (m ³ /h)	Presioni (m)	Fuqia aktive (kW)	Faktori i fuqisë (0 < cosφ < 1)	Rendimenti η (performanca) %	Efienca e energjisë (wh/m ³ /mku)	Rendimenti i synuar η (performanca) %
1	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i Vjetër n°1	P1	Çmontuar							
2	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i Vjetër n°1	P2	Çmontuar							
3	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i Vjetër n°1	P3	Çmontuar							
4	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i Vjetër n°1	P4	Kufizime në punë							
5	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i Vjetër n°1	P5	Kufizime në punë							
6	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i nr. 1	P1	Kufizime në punë							
7	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i nr. 1	P2	Përfunduar	437	79	136.7	0.82	69.3%	3.933	75.50%
8	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i nr. 2	P1	Kufizime në punë	500	75	129.5		79.1%	3.444	75.43%
9	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i nr. 2	P2	Përfunduar	500	75	129.5	0.82	79.1%	3.444	75.43%
10	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i Vjetër n°3	P1	Kufizime në punë							
11	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i Vjetër n°3	P2	Kufizime në punë							
12	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i nr. 3	P1	Përfunduar	541	73	136.9	0.82	78.5%	3.473	75.52%
13	Elbasan	Elbasan	Frigoriferi	Stp i nr. 3	P2	Përfunduar	554	74	132.2	0.84	84.2%	3.236	75.46%

Të dhënat tregojnë se shumica e pompave të vlerësuara po performojnë nën nivelet e rendimentit optimal dhe të garantuar. Megjithatë, sugjerojmë të mbahen pompat që janë brenda 15 viteve të instalimit, në vend që të zëvendësohen menjëherë, duke u fokusuar në rastet më kritike. Dhe pompat e puseve të rehabilitohen, dhe ose nderohen vetëm në rastet që kanë dalë jashtë funksionit.

Rekomandimet:

